



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:056076

Datë: 06.03.2024

Numri i dokumentit: 05417718

P.nr.881/2018

Gjykata Themelore në Prizren – departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Luan Berisha, Jnë lëndën penale kundër të akuzuarit M.B., nga Prizreni, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës nr. 04/L-082 (KPK), sipas aktakuzës të Prokurorisë të Shtetit në Prizren, PP.nr. 1448/2015 të datës 30.11.2016, jashtë seancës gjyqësore me datë 28.02.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET aktakuza e Prokurorit të Shtetit në Prizren, PP.nr. 1448/2015 të datës 30.11.2016, dhe **PUSHON** procedura penale sa i përket të akuzuarit M.B., nga Prizreni, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës nr. 04/L-082 (KPK), për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria e Shtetit në Prizren, kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.nr. 1448/2015 të datës 30.11.2016, kundër të akuzuarve M.B., I.B., dhe H.B.; që të tre nga Prizreni, për shkak të veprës penale për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës nr. 04/L-082 (KPK), si dhe kundër K.S., nga Prizreni, për shkak të veprës penale për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1 të Kodit Penal të Kosovës nr. 04/L-082 (KPK),

Nga shkresat e kësaj lënde rezulton se lënda është paraqitur në gjykatë dhe ate aktakuza me datë 30.11.2016, ndërsa vepra penale është kryer me datën 03.11.2014, ndërsa te gjyqtari gjykues kjo lëndë është pranuar me datën 15.12.2016.

Me aktvendimin P.nr.2633/2016 të datës 26.03.2018, është veçuar lënda kundër të akuzuarit M.B., nga Prizreni, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga

neni 333 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës nr. 04/L-082 (KPK), ndërsa procedura ka vazhduar ndaj të akuzuarve I.B., dhe H.B., për shkak të veprës penale për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës nr. 04/L-082 (KPK), si dhe kundër K.S., për shkak të veprës penale për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1 të Kodit Penal të Kosovës nr. 04/L-082 (KPK), ndaj të cilëve gjykata me aktgjykimin P.nr.2633/2016 të datës 10.04.2018, komform nenit 363 par.1 pika 1.1 ka refuzuar akuzën për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza.

Pranë kësaj gjykate disa herë është caktuar seanca gjyqësore në të cilat seanca nuk kanë qenë prezent i akuzuari ose i dëmtuari Gjykata sipas detyrës zyrtare ka caktuar disa seanca gjyqësore, nga të cilat disa seanca janë mbajtur, e disa seanca janë shtyer, ngase kanë munguar njëra nga palët dhe në mungesë të kushteve ligjore për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor të njëjtën nuk e ka mbajtur.

Në rastin konkret pas shiqimit të shkresave të lëndës gjykata ka ardhur në përfundim se duke pasur parasysh që vepra penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1 të Kodit Penal të Kosovës nr. 04/L-082 (KPK), është e dënueshme me burgim deri në 1 (një) vit, në bazë të dispozitave ligjore në kuptim të dispozitave të nenit 106 par.1 nën paragrafi 1.6 dhe nenit 107 par.8 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të paraparë të parashkrimit, gjegjësisht ndalesa absolute mbi ndjekjen penale, duke pasur parasysh që në rastin konkret kanë kaluar 4 (katër) vite nga kryerja e veprës penale.

Pra vepra penale nga ana e të akuzuarit është kryer me datën 03.11.2014, me ç ‘rast del se ka kaluar dyfishi i kohës së parashkrimit dhe atë 4 vjet, duke llogaritur prej ditës së kryerjes së veprës penale në bazë të dispozitave ligjore të lartëcekura. Parashkrimi absolut i ndjekjes penale në rastin konkret është arritur me datën 03.11.2018

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marë në kuptim të nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 454 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitave të këtij aktvendimi, konform nenit 358 par.1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I P;RGJITHSH;M
P.nr.881/2018 me datë 28.02.2022**

**Procesmbajtësja
Naxhis Sharani**

**Gjyqtari
Luan Berisha**

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj ankes në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të njëjtës kolegjit penal të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.